



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 2484 / prot

Koplik më: 01/09 / 2022

V E N D I M

Nr 40 datë 31/08/2022

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 31.08.2022, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë" seksioni 3 neni 14, neni 15 pika 1/a, pika 2/b, neni 16/1. VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

V E N D O S I

1. T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. Metush Ali Vuçaj (pas vdekjes) me motivacionin:

"Për kontributin e dhënë në Çlirimin e Atdheut dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë. Për punën drejtuese e organizues në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si dhe për veprimtarinë e shquar në pajtimin e gjaqeve e kuvendëve të burrave, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.08.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.09.2022





REPUBLICA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESIE E MADHE

REPUBLICA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESIE E MADHE

Nr 2444 .prot

Koplik më: 30/08/2022

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Metush Ali Vuçaj (pas vdekjes)



Metush Ali Vuçaj, ka lindur me 09 Gusht 1930 në fshatin Vuç-Kurtaj, Nj.A.Shkrel, Bashkia Malësi e Madhe. Ai u rrit në një familje fisnike por shumë atdhetare të Malësisë së Madhe. Që në moshë të re është shquar për vlera patriotike e organizative. Ka qënë partizan gjatë LANÇL por dhe pas saj veprimtar i shquar i organizates se luftes dhe deshmoreve te atedheut. Nga këto organizata si para dhe pas vdekjes ka fituar medalje e tituj të ndryshëm nderi. Pas Çlirimit të Atdheut pasi ka ndjekur shkolla e kurse profilizimi ka kryer detyra të ndryshme si brigadier, përgjegjes sektori etj. në ish-ekonomi bujqësore deri në vitin 1990 periudhë qe doli edhe në pension pleqërie. Është shquar si pajtues i gjaqeve e kudo ku është kërkuar edhe si njeri i kuvendëve në Malësi mes burrave të shquar e të nderuar të trevës tonë e më gjërë. Në karrierën e tij për punë të mirë në sektor të ndryshem ka fituar tituj dhe medalje te ndryshme. Ka qënë i dashur dhe i komunikueshëm me këdo në komunitet duke patur cilesi të larta njerëzore.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " (pas vdekjes) i Bashkisë Malësi e Madhe me **motivacion:**

"Për kontributin e dhënë në Çlirimin e Atdheut dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë. Për punën drejtuese e organizues në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si dhe për veprimtarinë e shquar në pajtimin e gjaqeve e kuvendëve të burrave, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

KRYETAR BASHKIE

TONIN MARINAJ

Adresa:Koplik-Qender

tel:021122650/2651

e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

